



**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E TRANSPORTIT E TRAFIKUT RRUGOR**

MIRATOHET

ERION VELIAJ

KRYETAR

DETYRË PROJEKTIMI

PËR REALIZIMIN E STUDIM-PROJEKTIMIT:


**STUDIMI DHE PROJEKTIMI I ELEMENTËVE TË SIGURISË
RRUGORE PËR RRJETIN EKZISTUES TË KORSIVE TË
BICIKLETAVE, PËRMIRËSIMI, SHTIMIN DHE KOMPLETIMIN E
TYRE**

Tiranë 2022

Bashkia e Tiranës, Drejtoria e Transportit e Trafikut Rrugor, me fondin 14,102,400 lekë me TVSH, kërkon të realizojë studim projektimin për objektin: **“Studimi dhe projektimi I elementeve të sigurisë rrugore për rrjetin ekzistues të korsive të bicikletave, permiresimi, shtimin dhe kompletimin e tyre”**, në qytetin e Tiranës.

1. Të dhëna dhe kërkesa të përgjithshme

Projekti përfshin rreth 38 km korsive ekzistuese për biçikleta dhe mundësinë e zgjerimit me 23 km të kësaj infrastrukture për plotësimin e “MinGrid” të parashikuar; Lidhjen/rrjedhshmërinë e infrastrukturës ekzistuese për biçikleta në kryqëzime si pjesë e zgjidhjes tërësore të trafikut, trajtimin e kryqezimeve për rehabilitim, elemente inovativ në infrastrukturë, sinjalistikë horizontale, vertikale dhe semaforike.



Gjendja e infrastrukturës në rrugë paraqitet:

1.1 Elementët e infrastrukturës rrugore dhe biçikleta

Rrugët kanë mungesë infrastrukture të korsive ose lidhjeve të atyre ekzistuese midis tyre.

1.2 Kanalizimet e ujërave të zeza

Ka nevojë të verifikohet rrjeti ekzistues i K.U.Z, të merret informacion nga UKT për gjendjen funksionale të tyre.

1.3 Kanalizimet e ujërave të bardha

Ka nevojë të verifikohet rrjeti ekzistues i kanalizimeve të ujërave të bardha, të merret informacion nga UKT për gjendjen funksionale të tyre.

1.4 Rrjeti ujësjellësit

Rrjeti ujësjellësit duhet të verifikohet.

1.5 Rrjeti i ndricimit rrugor

Ndriçimi rrugor duhet të verifikohet.

1.6 Rrjeti i internet telefonisë

Duhet të verifikohet rrjeti i internet telefonisë.

1.7 Gjelbërimi

Duhet të verifikohet gjelbërimin rrugor.

1.8 Sinjalistika rrugore

Duhet verifikuar Sinjalistika rrugore vertikale ose horizontale.

1.9 Pikat e VGM-së

Duhet verifikuar pikat e koshave të grumbullimit të mbetje urbane.

Objekt i projektit do të jetë rishikimi i akseve ekzistuese të korsive të bicikletave dhe ndërtimi i infrastrukturës së re të propozuar për korsitë/lidhjet e tyre të dedikuara për biçikleta me të gjitha elementët e nevojshëm, me qëllim përmirësimin e cilësisë, rrjedhshmërisë, elementeve të sigurisë në lidhje me zgjidhjet optimale të qarkullimit multimodal në nyje dhe shtrirje gjatësore.

2. Kërkesat e projektit

Gjatë studimit dhe hartimit të projektit, të mbahen parasysh Studimet Urbanistike Pjesore (nëse ka), parashikimet e Planit të Ri Rregullues dhe Masterplani i Transportit ku përfshihet planifikimi i rrjetit minimal të korsive të rezervuara për biçikleta (min.grid). Gjithashtu, për të përcaktuar saktë kapacitetin për të gjitha shërbimet e kërkuara, duhet patur parasysh koeficienti i dendësisë së popullsisë, sipas Rregullores së Urbanistikës në fuqi ose 400 banorë/ha, si dhe duhen marrë në konsideratë zhvillimet urbane të pritshme dhe në perspektivë të zonës/bllokut në fjalë.

Projekti do të trajtojë :

1. Rishikimin e të gjithë akseve ekzistues të korsive të bicikletave duke bërë një vlerësim të detajuar për gjendjen ekzistuese, nevojat për ndërhyrje në infrastrukturë (mungesë stabiliteti apo demtime të strukturas së paketës së shtresave) dhe vlerësimi i sigurisë rrugore gjatë levizjes së përdoruesve. Projektuesi do të kushtojë rëndësi të veçantë analizimit të sigurisë rrugore të levizjes në akset ekzistuese duke analizuar dhe raportuar të gjitha problematikat që mund të cenojnë levizjen e sigurt dhe të rrjedhshme të përdoruesve. Do të propozohen alternativa dhe zgjidhje në rast të mungesës së sigurisë, defekteve të ndërtimit, problemeve të qëndrueshmërisë strukturore apo probleme të pengesave fizike që e bëjnë të pamundur tranzitimin në aksin ekzistues.

2. Projektin e zbatimit të akseve të reja të propozuara nga Bashkia e Tiranës, të cilat për zhvillimin e projektit do të studiohen dhe do të konsultohen në Bashki mbi beshmerinë e tyre. Projekti i zbatimit të këtyre akseve do të përfshijë paketën e plote të detajuar për ndërtim për të gjithë infrastrukturën rrugore, duke përfshirë dhe spostimet/rialokimet e rrjetit ekzistues inxhinierik që mund të preken nga projekti (linjat e kanalizimeve, ujsjellsit apo ndricimit).

2.1 Infrastruktura e korsive të bicikletave

Për trajtimin e rrjetit rrugor, gjerësisë së korsive të bicikletave dhe trotuareve, duhet të mbahen parasysh standartet në fuqi (Rregullorja e urbanistikës, KTP).

Shtresat rrugore dhe të trotuarëve të trajtohen të tilla, që të sigurojnë garanci, qëndrueshmëri, komoditet, vizualitet dhe të përballojnë kapacitetet faktike dhe të perspektivës.

Rekomandohet që materialet, që do të përdoren, të jenë sipas kushteve teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve dhe për uniformitet të parashikohet përdorimi i asfaltit të kuq.

Për përcaktimin e ndërhyrjeve dhe parashikimeve të reja infrastruktururore, paraprakisht përveç grumbullimit dhe hartimit të materialeve ndihmëse të kryhen verifikime dhe analiza (listë kontrolli i gjëndjes aktuale) për evidentimin e elementeve që ndikojnë ose janë pjesë e sigurimit të qarkullimit të biçikletave. Këtu përfshihet çdo pengesë dhe planifikim për rehabilitim të kurorave të gjelbërta, dëmtim karrexhate, vënd grumbullim të mbetjeve urbane dhe elementit ndarës/mbrojtës të kësaj korsie të përshtatshme për evitimin e “kërcimit të rrotave” ose në rast disnivele (trotuare) daljen e menjëhershme në korsitë e mjeteve.

Grupi i punës duhet të konsultohet vazhdimisht me Bashkinë Tiranë gjatë të gjitha fazave të studimit, projektimit dhe zbatimit të tij dhe kjo si për garantimin e saktësisë së bazës së të dhënave, ashtu edhe për reflektimin e ndryshimeve të pritshme nga plan/studimet e përmendura më sipër.

Përveç saktësisë së të dhënave si më sipër, projektuesi, përpara se të fillojë punën me projektimin duhet, që paraprakisht:

- Të bëjë relievin (azhornimin) e korsive ekzistuese të bicikletave dhe rilevimin e siperfaqeve ku parashikohet të ndërtohen korsitë e reja të bicikletave si dhe të jepet plani i piketimit (me pikat e forta etj);
- Të marrë të gjitha azhornimet e rrjetit të infrastrukturës që preken nga projekti, sipas formularit 3/1;
- Projektuesi duhet të bëjë verifikim paraprak në terren dhe sondime (nese do të jete e nevojshme) për saktësinë e të dhënave/azhornimeve, për rrjetin e infrastrukturës përpara fillimit të projektimit. Kjo duhet në mënyrë, që të evitohen pasaktësitë gjatë projektimit dhe zbatimit, si rezultat i të dhënave të marra, që nuk përputhen me gjëndjen në terren;
- Të bëjë studimet përkatëse gjeologjike, hidrologjike për akset e reja të korsive të bicikletave etj. (sipas kërkesave të projektimit dhe formularit 3/1).

2.2 Skema e rrjetit rrugor

Bazuar sa më sipër kërkohet, që projektuesi të organizojë punën e tij projektuese në disa faza. Mbasi të përfundojnë azhornimet në terren, verifikimet si dhe studimet e nevojshme, projektuesi bën një analizë të shkurtër të situatës dhe konsultohet me Bashkinë, ku merr edhe

të dhënat e para mbi ecurinë e planeve/studimeve dhe ndikimin e tyre në projektin e tij për Min Grid-in e korsive për bicikleta.

Projektuesi harton paraprakisht:

- a. **relacion teknik**
- b. **një analizë të situatës ekzistuese**

Qëllimi i kësaj fazë është, që projekti të ketë analizë të përputhshmërisë me planet, efikasitetin ekonomik të ndërhyrjes, pra efektivitet të kostos, minimizim të impakteve negative sociale (si p.sh të prishjeve të panevojshme për këtë fazë, etj)..

2.3 Skema e qarkullimit/lëvizjes

Projektuesi duhet të hartojë dhe të paraqesë paraprakisht së bashku me skemën e rrjetit të korsive të bicikletave edhe analizën dhe skemën e qarkullimit/lëvizjes në rrugë. Kjo skemë duhet të jetë fletë e veçantë e projektit.

Projekti/skema duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë një zgjidhje për përdoruesit e korsive të bicikletave dhe njehohesit të mos cenohen:

- Aksesibilitetin dhe qarkullimin normal për të gjitha kategoritë e mjeteve, duke përfshirë rastet dhe mjetet e emergjencës (sidomos ato të zjarrit, shëndetit etj);
- Aksesibilitetin e këmbësorëve duke i dhënë një përparësi të qartë në rezervimin e hapësirës së lëvizjes si dhe duke parashikuar lidhjen e lëvizshmërisë së tyre në zonë;
- Aksesibiliteti i personave me aftësi të kufizuara;

Projektuesi duhet të marrë në konsideratë:

- Mundësinë e ndërtimit të vendparkimeve për bicikleta sipas kritereve baze dhe referuar kërkesave depozituar pranë Bashkisë Tiranë (në rast se e lejojnë kushtet fizike)
- Të gjithë elementët e mësipërm të ndërthuren në një projekt sinjalizimi rrugor duke siguruar një organizim të lëvizjes, që përmbush kërkesat si të banorëve ashtu dhe të aktiviteteve të mundshme ekonomike të zonës;
- Parashikimin e mënyrës së lidhjes së korsive të bicikletave me akset kryesore dhe blloqet e banimit kufitarë;
- Plotësimin e elementëve të sigurisë rrugore për korsitë e bicikletave duke trajtuar me kujdes të gjithë elementët (kalimet këmbësore, këndet e shikimit, ndriçimi, kryqezimet automobilistike etj.).

2.4 Siguria dhe sinjalistika rrugore

Siguria e përdoruesve të bicikletave kërkon rrugë më të sigurta me qëllim promovimin e çiklizmit si një mënyrë transporti. **Evidentimi i pikave të rrezikut** është një nga objektivat e sigurisë rrugore. Duke qenë që jeta dhe shëndeti i njeriut janë prioritarë atëherë koeficienti i sigurisë për lëvizjen e bicikletave merr përparësi, krahas asaj këmbësore, mbi lëvizjen dhe objektivat e tjerë të sistemit të trafikut rrugor".

Në rishikimin e infrastrukturës ekzistuese dhe dizenjimin e korsive të reja për bicikleta, nga pikpamja e sigurisë, projektuesi duhet të trajtojë elementët si më poshtë:

- Pengesat fizike ; çiklistët do të duan të mbajnë distancën e tyre nga bordurat, skajet dhe muret. 0.25 m; për muret e gurta më të larta 0.50 m, për muret e mbyllura 0.6 m.

- Cilësia e shtreses konsumuese
- Kalimet në kryqezime. Nuk ka rëndësi se sa e sigurt, e veçuar ose e mbrojtur mrekullisht është infrastruktura e çiklizmit nëse kryqëzimet ku çiklistët përzihen me automjete janë të rrezikshme. Për të shmangur përplasjet, është e rëndësishme që të ketë uniformitet të qartë në të gjitha vendkalimet dhe që ato të jenë relativisht të vetë-shpjegueshme. Kjo rrit parashikueshmërinë ndërmjet shfrytëzuesve të rrugës. Udhezim: Në kryqezime me semafor mund të tërhihet vija STOP 3m nga vija stop për bicikleta, kurse rrethrotullim çiklistët janë vendosur 5 metra prapa nga rrethrotullimi.
- Minimizimi i manovrave (kujdes 90 o)
- Dukshmeria në pikat e konfliktit, hyrje- daljet dhe tipi i tyre, parakalimi, gjerësia e korsive për qarkullim të përzier të mjeteve, pikave të konfliktit në një kryqëzim e deri te këmbësorët në mjaftueshmërinë e pikave të kalimit të këmbësorëve dhe krijimin e rampave.

Në funksion të planeve të qarkullimit, vendoset sinjalistika përkatëse, e cila përfshin atë vertikale, horizontale dhe semaforike. Hartimi i projekteve për zbatim të sinjalizimit rrugor të jetë sipas planeve urbane me synim standartizimin e kushteve të qarkullimit dhe sigurisë rrugore, në përputhje me rregullat urbanistike dhe planin e transportit, sikurse për t'i dhënë përdoruesve të rrugës informacionin e duhur për të qarkulluar në mënyrë të sigurt dhe të ligjshme.

Për sinjalistikën horizontale do të përdoret bojë speciale bikomponente. Sinjalistika vertikale duhet të pasurohet me të gjitha tabelat e nevojshme (orientimi, lartësia, pozicionimi dhe përmasat e tabelave të sinjalistikës vertikale jepen në Rregulloren e Kodit Rrugor të Shqipërisë (RrKRRSh) në funksion të qarkullimit të sigurt të përdoruesve të korsive të bicikletave.

Në territore me ndërtime, tabelat duhet të vendosen më lart. Kur ato ngrihen në trotuare apo ku ka lëvizje këmbësorësh, duhet të lejojnë një qartësi të mjaftueshme për këmbësorët: preferohet 230 cm dhe 220 cm si minimum. Pranë kryqëzimeve të vendosen sinjalistikë vertikale për secilën rrugë sipas senseve të orientimit përkatës (nese eshte e nevojshme).

Llojet e sinjaleve rrugore, vertikale dhe horizontale, të vlefshme për përdorim, jepen në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë (Korrik 1998) dhe “Rregulloren e Zbatimit të Kodit Rrugor Shqiptar” (Prill 2001).

Të trajtohet në projekt mënyra e lëvizjes si dhe masat e sigurisë së këmbësorëve gjatë punës për realizimin e objektit në të gjitha fazat. Projektuesi duhet të paraqesi në flete të veçanta të gjitha detajet e nevojshme të masave të sigurisë që do të reflektohen edhe në preventiv. Skema e rrjetit rrugor+plani i propozuar i ndërhyrjes për lirim të sheshit të ndërtimit (prishjet) do të diskutohen me Bashkinë dhe pasi të marrë miratimin e saj, projektuesi vazhdon me detajimin në projekt-zbatim të korsive të bicikletave.

2.6 Kanalizimet e ujërave të zeza dhe ujërave të shiut

Nese gjate projektimit te akseve te reja apo ne azhornimin e akseve ekzistuese lind nevoja e spostimit apo rindertimit pjesor te rrjetit te kanalizimeve te ujrave te bardha apo te zeza, projektuesi do te reflektoje te gjitha punimet e nevojshme ne projekt zbatim bazuar ne azhornimet e fundit te rrjetit ekzistues nga institucionet perkatese dhe ne rilevimin topografik. Pusetat duhet te jenë te pajisura me shkallë metalike.

Për rrjetin e kanalizimeve të ujërave të shiut do të përdoren puseta betoni me zgarë me kapak me material kompozit.

2.7 Ujësjiellësi

Në bashkëpunim me Ujësjiellës–Kanalizime sh.a. do të saktësohet dhe gjendja e ujësjiellësit ekzistues, projektet, që ka kjo ndërmarje brenda kufirit të projektit. Në rast se lind nevoja e spostimit apo indertimit pjesor të rrjetit të ujësjiellësit për shkak të punimeve të korsive të bicikletave , projektuesi do të reflektojë të gjitha punimet e nevojshme në projekt zbatim bazuar në azhurnimet e fundit të rrjetit ekzistues nga institucionet përkatëse dhe në rilevimin topografik.

2.9 Elementët urban

Projektuesi do të trajtojë në fazën e projektit të gjithë elementet urbane që mund të kenë konflikt me projektin e korsive të bicikletave.

Do të jetë pjesë e projektit, trajtimi dhe detajimi teknik (faza/projekt zbatim) për secilin prej këtyre elementëve të hapësirës urbane të cilet për shkak të implementimit të korsive të bicikletave kanë nevojë të spostohen dhe të ripozicionohen (si psh , vendin e vendosjes së kontenerëve dhe të largimit publik të mbeturinave (përcaktimi i tyre të bëhet në bashkëpunim me Drejtorinë e Pastrimit në Bashki), zgara apo rrethime të pemëve, kangjella kufizuese në trotuare (kur është rasti) si dhe bllokues të mjeteve në trotuare, zgarat për biçikletat, etj.) Koshat për hedhjen e mbeturinave duhet të jenë të komandueshme për tu pastruar lehtësisht nga shoqëritë përkatëse të pastrimit, dhe kjo duhet të specifikohet në projekt në detajin përkatës.

Të verifikohen dhe zvendeshen lidhjet e ullukëve të shkarkimit të tarracave me pusetat K.U.SH. të rrugëve, duke parashikuar punime për t'i kaluar nën nivelin e trotuareve të rrugës dhe lidhjen e tyre deri në pusetën K.U.SH. më të afërt në rast se do të ndikohen nga projektin.

Detaje teknike të ndryshme për ndërhyrjet, që do të propozohen.

Projektuesi duhet të trajtojë këto elementë në fazën e projektit të zbatimit (me të dhëna të plota për furnizim-vendosje), ku të përcaktojë detaje tip, llojin e materialit, detaje të inkastrimit, ngjyrat, sasinë, zërin në preventiv etj.

3. Fazat e Zbatimit

Për efekt të fondit të zbatimit, të realizimit të prishjeve (të mundshme) si dhe të efikasitetit të ndërhyrjes, projektuesi mund t'i rekomandojë investitorit fazat e realizimit në kohë (ose sipas elementëve të ndryshëm) të projektit.

Projektuesi mund t'i rekomandojë Investitorit, që projektin të realizohet në disa faza ose lote, si dhe sipas elementëve të ndryshëm të tij

Lidhur me këtë fakt, projektuesi do të propozojë fazat e realizimit të projektit, ku të dhënat (si fletët e projektit, preventiva, grafiku i punimeve) për çdo fazë duhet të jenë të konceptuara ose të organizuara, që të lehtësojnë Investitorin në organizimin e zbatimit (buxhetim, prokurim, kontraktim për zbatim) të projektit me faza.

3.1 Standartet

3.1.1 Standarte në projektim

Projektin do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim, që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standareve të reja, për përafrimin me normat e BE-së, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elementë të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës.

Në hartimin e projektit të mbahen parasysh të gjitha normat e miratuara për PAK (personat me aftësi të kufizuar). Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori nese ajo do te preket nga projekti.

Detajet teknike të infrastrukturës për këtë kategori, të jepen nga projektuesi në fletë të veçanta të projektit.

3.1.2 Standarte në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, me të avancuara të fushës. Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të parashikohet dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji “Për urbanistikën”, Rregullorja e Urbanistikës dhe Legjislacioni në fuqi.

3.2 Realizimi i projektit

FAZA I Projekt ide paraprake (Përgatitja e projektit dhe planifikimit).

Përpunimi pjesëve të rëndësishme të një zgjidhjeje të detyrës së planifikimit, e cila do paraqitet në jo më pak se 2 variant-propozime, ku për secilin variant do dorëzohet:

- a. Vizatimet teknike (planimetri e përgjithshme, prerje tip të rrugës për secilin variant);
- b. Relacion teknik (mbi ndërhyrjet e parashikuara)
- c. Preventiv paraprak;

Varianti me treguesit më te favorshem social - ekonomik dhe teknik, që do të përzgjidhet nga Këshilli Teknik dhe do të vazhdojë procedurën e hartimit të projekt-idesë përfundimtare.

(Të paraqiten variantet e propozuar me preventivat paraprake duke përfshirë dhe kostot e shpronësimeve, nëse ka, për secilin variant).

Materialet dorëzohen ne format hard copy (të printuar) dhe cd në formate soft copy (cad,exel,ëord etj.)

FAZA II Projekt ide përfundimtare (planifikimi i sistemit dhe i integritit)

Përpunimi i zgjidhjes përfundimtare të detyrës së planifikimit.

Pas miratimit në Këshill Teknik të variantit socio-ekonomik dhe teknik më të përshtatshëm të miratuar në fazën e projekt idesë paraprake, procedohet me projekt-idenë përfundimtare, e cila duhet të përmbajë:

- a) Raport teknik;
- b) Preventivin e punimeve sipas formatit të miratuar nga Bashkia Tiranë, referuar VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”;
- c) Analizat teknike të çmimeve, për zërat, që nuk ndodhen në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

- d) Vizatimet teknike për të gjitha punimet e parashikuara me detajet përkatëse.
- e) Grafikon e punimeve të detajuar sipas zërave të punës;
- f) Rilevimi i zones ne studim;
- g) Studimi gjeologjik dhe hidrologjik per rrjetin e ri te bicikletave;

Materialet dorëzohen ne format hard copy (të printuar) dhe cd në formate soft copy (cad,exel,ëord etj.)

Pranë Drejtorive përkatëse të Bashkisë dhe institucioneve në varësi, kryhet aplikimi për vendosjen në dispozicion të informacionit në lidhje me azhornimet inxhinierike, statusin juridik të pronës etj.

FAZA III: Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit: Përpunimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurat e nevojshme juridike e ligjore.

Projektuesi gjithashtu duhet të parashikojë dhe projektin për miratimin e lejes së ndërtimit, i cili duhet të mbështetet në ligjin Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”. Për këtë për çdo dokumentacion të nevojshëm për hartimin e projektit si dhe për aplikimin për leje ndërtimi përmes portalit të Regjistrimit të Integruar të Territorit, të bashkëpunohet me Drejtorinë përkatëse të Bashkisë Tiranë.

FAZA IV: Projekti zbatimit: Përpunimi dhe paraqitja e planit të zgjidhjes së gatshme për zbatim.

Dosja e plotë e projektit të zbatimit për objektin: **“Studimi dhe projektimi te elementeve te sigurise rrugore për rrjetin ekzistues të korsive të bicikletave, përmirësimi, shtimin dhe kompletimin e tyre”.**

Projekti I zbatimit do te permbaje te gjitha dokumentacionin e nevojshem per ndertimin e akseve te reja te korsive te bicikletave dhe te gjitha nderhyrjet e nevojshme ne rrjetin ekzistues per te garantuar sigurine dhe komoditetin ne levizje te perdoruesve te tyre.

Dosja e projektit te zbatimit do te permbaje:

1. Raporti Teknik
2. Hartimi i relievit topografik të zones ne studim(korsite e bicikletave ekzistuese, gjurma e parashikuar e akseve te reja) (koordinata lokale KRGJSH, kuota absolute)
3. Pasqyrimi në projekt i azhornimeve të rrjetit ekzistues të ujës-jellësit, rrjetit të kanalizimeve të ujërave të shiut dhe të zeza, rrjetit të elektrikut dhe internet – telefonisë të zones ne studim aty ku do te aplikohen nderhyrje;
4. Raport gjeologjik i zones ku do te kalojne akset e reja dhe vleresimi i situates se akseve ekzistuese;
5. Analizë e situatës ekzistuese dhe të prishjeve të ndërtimeve pa leje (nëse ka);
6. Skemën e qarkullimit në rrugë;
7. Raport i sigurise rrugore te qarkullimit te bicikletave.
8. Raport mbi menaxhimin e trafikut si pasoje e implementimit te rrjetit te ri te bicikletave.
9. Analize e zgjidhjeve teresore, studim i akseve ekzistuese dhe atyre te reja ,shoqeruar me mikrosimulime ne raste te vecanta kur do te gjykohet e nevoshme.
10. Plan menaxhimi trafikut me analize per cdo zgjidhje.
11. Projektin e zbatimit të akseve te reja te korsive te bicikletave
12. Profilin gjatësor te akseve te reja te korsive te bicikletave
13. Profilat tërthorë të akseve te reja te korsive te bicikletave
14. Profilat tip të seksionit tërthor të akseve te reja te korsive te bicikletave

15. Detajet e ndryshme të trotuarit, bordurave, etj;
16. Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të largimit të ujrave të shiut qe preken nga projekti ne fjale.
17. Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të ujrave të zeza qe preken nga projekti ne fjale.
18. Projektin e zbatimit të rrjetit të ujësjellësit qe preken nga projekti ne fjale, përfshirë dhe detajet e pusetave të pajisjeve dhe rakorderive të nyjeve,
19. Projektin për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi, në vendosjen e hidrantëve zjarrfikës mbështetur në normat në fuqi qe preken nga projekti ne fjale(nese ka)
20. Projektin e ndriçimit rrugor, skema e furnizimit me energji elektrike dhe detajet përkatëse qe preken nga projekti ne fjale.
21. Projektin e zbatimit për ndërtimin e rrjetit të linjave rezervë qe preken nga projekti ne fjale.
22. Sinjalistikën rrugore horizontale, vertikale dhe Semafore(nese lind nevoja per semaphore te rinj);
23. Specifikimet Teknike për zërat e punimeve që do të kryhen;
24. Preventivin e punimeve mbështetur në manualet teknike të çmimeve në fuqi;
25. Grafikon e punimeve të ndërtimit;
26. Plan organizimin e punimeve dhe ngritjen e kantierit në funksion të mjeteve, që do të jenë pjesë e realizimit të objektivit, mbështetur dhe në grafikon e punimeve;
27. Raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) sipas standarteve dhe ligjeve shqiptare ne fuqi;
28. Liçensë të firmës projektuese, liçensë të ekspertit mjedisor dhe ekstrakt i regjistrit tregtar.

Materialet e sipërcituara duhen dorëzuar fizikisht dhe në formatet përkatëse: dwg., word, exel.

FAZA V: Hartimi i preventivit përfundimtar

Për hartimin e preventivit projektuesi duhet të mbështetet në VKM NR. 629, datët. 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Për secilin zë punimi, i cili nuk është i përfshirë në këtë manual, projektuesi duhet të dorëzojë analizat/ofertat përkatëse të çmimeve.

Në hartimin e preventivit, veç të tjerave do të mbahen parasysh sa më lart, lidhur me organizimin e zbatimit me faza, çmimet e referencës sipas akteve ligjore në fuqi, dhe llogaritja e preventivit do të bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi për të siguruar kursimin dhe efijencën e përdorimit të fondeve.

Preventivi do të përpilohet sipas formatit/modelit standart të rekomanduar nga Bashkia Tiranë.

Dorëzimi final, fizik, i projektit të zbatimit, do të konsiderohet ai, i cili do të ketë kaluar njëherë të gjitha fazat e mësipërme dhe në rast se preventivi i projekt-zbatimit do të ketë vlerë të barabartë apo më të madhe se 100,000,000 lekë më t.v.sh., projekti do t'i nënshtrohet oponencës teknike të Institutit të Ndërtimit, sipas afateve përkatëse. (të miratuara përkatësisht nga Këshilli Teknik i Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike).

4. Rekomandime për projektuesin

- a) Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me korsite e bicikletave. Projektuesi duhet të hartojë, përveç projektit përfundimtar dhe një propozim teknik, i cili duhet të analizojë rast pas rasti të gjitha alternativat e mundshme për të realizuar me faza këte investim.
- b) Projektuesi duhet të përdorë studimet dhe të dhënat paraprake te transportit, që disponohen nga Bashkia e Tiranës.

c) Projektuesi do të bashkepunoje ngushtesisht me Bashkinë e Tiranës gjatë procesit të analizimit dhe studimit të projektit për të koordinuar dhe implementuar zgjidhjet e dhena në projektim në sistemin teresor të qarkullimit të mjeteve në qytetin e Tiranës, në funksion të sigurisë rrugore dhe levizjes komode të përdoruesve të saj.

d) Në hartimin e projektit duhet të merren në konsideratë edhe standarde të ndryshme, që ka nxjerrë Bashkia e Tiranës, siç janë p.sh. tipi i kollonave të ndriçimit, llojet e ndriçuesve e të tjera të kësaj natyre (nese do të jete e nevojshme).

4.1 Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar:

Projekti do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë e Tiranës. Stafi, që kërkohet duhet të përfshijë:

- Inxhinier ndërtimi për rrugë;
- Inxhinier hidroteknik;
- Inxhinier mekanik;
- Inxhinier gjeolog;
- Inxhinier topograf;
- Inxhinier elektrik;
- Inxhinier elektronik;
- Arkitekt;
- Ekspert mjedisi;
- Staf mbështetës për fushat e mësipërme.

5. Raportimi

I gjithë dokumentacioni do të paraqitet në 5 (pesë) kopje, në format soft copy dhe hard copy dhe 5 (pesë) kopje në CD. Gjithashtu do dorëzohet versioni i dixhitalizuar i cili transferohet në GIS.

Një nga këto kopje do të nevojitet për aplikim përmes portalit të Regjistrimit të Integruar të Territorit.

6. Relacioni teknik, i cili shoqëron projektin duhet të përmbajë:

- Përshkrimin e zgjidhjeve të dhena dhe të dakordesuara në fazat e mëparshme
- Llogaritjet statike të strukturave (në rast kur kemi të parashikuar mure mbajtëse etj.)
- Raportin teknik, ku përveç llogaritjeve të sipërpërmendura, do të jepen llogaritjet e shtresave, të dhëna të sakta bazuar në teste për gjendjen egzistuese, masat inxhinierike që janë parashikuar të merren, raporti gjeologjik, siguria e kalimit në rrugë dhe masat që duhet të merren për rregullimin e trafikut gjatë punimeve të ndërtimit dhe specifikimet teknike për çdo zë pune.
- Metoda e llogaritjes së shtresave të jetë e bazuar në CBR.
- Preventivi i plotë i kostos së ndërtimit të veprës.
- Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) sipas standardeve të ligjit shqiptar në fuqi

7. Hidrologjia

- Të bëhet studimi hidrologjik i zones ne studim për të përcaktuar nevojen e implementimit te sistemeve te drenazhimit ne rast se mungojne apo zvendesimin dhe spostimin e tyre ne rast se do te preken nga projekti ne fjale

8. Planimetria e Shpronësimeve

Kjo planimetri do të identifikojë pronat dhe godinat, që preken nga realizimi i projektit shoqëruar me llogaritjen e sipërfaqes, që preket për arsye shpronësi.

9. Paraqitja e vizatimeve

Vizatimet e projektit duhet të përmbajnë minimalisht fletët si mëposhtë:

- Horografia
- Topografinë e gjendjes ekzistuese e kufizuar per korsite ekzistuese te bicikletave dhe gjurmes se parashikuar te korsive te reja , në të cilën të jenë të azhornuara të gjitha elementet e nevojshem per te realizuar nje projekt te detajuar (pusetat, tabela te sinjalistikes, shtylla ndricimi, peme etj)Shk. 1:500 ose 1:1000;
- Planimetria e korsive te bicikletave në Shk. 1:500 ose 1:1000;
- Planimetria e prishjeve në shkallë 1:500;
- Profilet gjatësorë te korsive te bicikletaveShk. 1:1000, 1:100;
- Profilet tërthorë të korsive te bicikletave jo më pak se 25 m;
- Detaje konstruktive tip të shtresave të rrugës, trotuareve, pusetave, etj.;
- Kryqëzimet dhe detaje përkatëse;
- Skemën e qarkullimit (semaforike) nese do te linde nevoja e rishikimit te skemes se qarkullimit
- Planimetria e rrjetit te spostuar të kanalizimeve në shkallën 1: 500;
- Profilet gjatësorë të rrjetit te spostuar të kanalizimeve në Shk. H1:1000,V1:100;
- Pusetat dhe detaje të tjera të rrjetit të kanalizimeve;
- Planimetria e rrjetit te spostuar të ujësjellësit në shkallën 1: 500;
- Profilet gjatësorë të rrjetit te spostuar të ujësjellësit në Shk. H1:1000,V1:100;
- Pusetat, detajet e nyjeve dhe lidhjeve si dhe detaje të tjera të rrjetit te spostuar të ujësjellësit;
- Planimetri dhe detaje për lëvizshmëri/sinjalistikën rrugore;
- Planimetria e mobilimit urban(nese ka);
- Detaje teknike të mobilimit urban(nese ka);
- Planimetria e ndriçimit rrugor dhe detaje të ndriçimit rrugor(nese ka);
- Planimetria e tubacioneve të rrjetit të internet telefonisë në shkallë 1:500(nese ka);;
- Detaje të mënyrës së vendosjes së PVC, të rrjetit të internet telefonisë dhe intersektimit me korsine e bicikletave SH 1:25(nese ka);;

Të gjitha fletët e vizatimeve duhet të jenë të detajuara me elementët përkatës, si dhe legjendat përkatëse.

10. Investimi Themelor

Investimi themelor do të dalë nga varianti më i mirë i miratuar nga Këshilli Teknik i Bashkisë së Tiranës.

11. Sqarime të fundit

Të dhënat e nevojshme për projektim, sikurse janë: gjendja e rrjetit ekzistues të ujësjellësit, të kanalizimeve, ndriçimit, kabinat e tensionit të lartë, vendosja e kontenierëve, planin rregullues të zonës, etj, do të merren nga projektuesi sipas formularëve përkatës.